



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:147684

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876271

KPPP.nr.841/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A., me seli në Ferizaj, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., me seli në rr. “Lagjja Kalabria”, Blloku B1, nr. 5, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.504/2021 të datës 26.08.2021, të lejuar nga Përbaruesi Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në çështjen përbarimore në mes të kreditorit Klubi i Futbollit Ferizaj SH.A., kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., e lejuar sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.504/2021 të datës 26.08.2021, të Përbaruesit Privat Besnik Aliu, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj të debitorit.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Besnik Aliu, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr.504/2021 të datës 26.08.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin mbi bazën e dokumentit - faturës nr. 611200/2021 të datës 06.11.2020, ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur të paguaj kreditorit shumën prej 10,000.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 22.11.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, ndërsa në rast të mos pagesës përbaruesi borxhin t’a

inkasoi përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare dhe ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat ose me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtuqë të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori deri në pagesën definitive.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke deklaruar se në urdhrin përmbarimor është një faturë me numër tjetër dhe jo ajo që është thirr kreditori në propozim. Më tutje ka theksuar se debitori nuk ka të drejtën e nënshkrimit të asnjë faturë, për shkak që nga vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës të gjitha kompetencat i kalojnë administratorit të përkohshëm. Ka shtuar se fatura është nuk kundërshtim me kriteret e parapara ligjore për t'u konsideruar si dokument përmbarimor. I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të refuzohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se propozimit i është bashkëngjitur fatura e lartcekur e cila përmban afatin e pagesës, si dhe është nënshkruar nga debitori. Në lidhje me marrëveshjen e sponzorizimit ka deklaruar se nuk ka qenë i obliguar që të vendosë banderolë reklamuese pa pranuar pagesën nga sponzorizuesi. Ka deklaruar se neni 6 i kontratës parasheh se shkëputja e marrëveshjes nuk i liron palët në asnjë mënyrë nga përmbaruesi dhe detyrimeve ndaj palës tjetër. Gjykatës i ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar për vendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, lidhur me këtë çështje juridike përmbarimore zyrtarisht është informuar që debitori Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021 të lëshuar nga Banka Qendrore të Kosovës, i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm.

Prandaj, gjykata në mbështetje të nenit 277, pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), i cili gjen zbatim përshtatshëmrisht në këtë çështje përmbarimore në përputhje me nenin 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur*

paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”, vlerëson procedura në këtë çështje juridike duhet të ndërpritet për shkak se debitori sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021, të lëshuar nga ana e BQK-së, i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm dhe tani ka cilësinë e debitorit në falimentim.

Nga sa më sipër, konform nenit nenit 17 të LPP-së në lidhje me nenin 277, pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 841/22, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.